REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 84 prot. Kamëz, më 21.9.2026

V E N D I M
Nr. 69 .Datë 21 / 9 2026
MBI

"MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË PËR VITIN 2026"

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.09.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.64 Datë 17.09.2026 në mbështetje të Kushtetutës, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" i ndryshuar, Ligji për Kodin Administrativ në Republikën e Shqipërisë, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave "Për normat e strehimit", Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.362 date 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak "Për ngritjen e Komisionit të Strehimit"; Vendimit nr.80 datë 20.11.2025 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e manualit të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë "; VKB nr 90 dt.17.12.2025 për "Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2026, 2027, 2028"; Relacionit të Komisionit të Strehimit me Prot 9780 datë 17.09.2026 , **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

V E N D O S I:

1. Miratimin e trajtimit me subvencionin e qirasë për 4 (katër) familje, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi me vlerë ***totale mujore 87,385 (tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tetedhjetë e pesë) Lekë.***

2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë **3 (tre)** mujore duke filluar nga data 01.10.2026 deri në datën 31.12.2026.

3. Rakordimin e vlerës së bonusit të qirasë për 1 familje, sipas relacionit pjesë përbërës i këtij Vendimi.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 ***do të përballohen në raportin 100% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.***

5. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij projektvendimi.

   Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI